# Poezi nga letrarë të rini

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTËR
8JH-1
P78

A. Rakipi, M. Ahmeti, M. Buçpapaj, R. Dibra, S. Vrushe
V. Dilo, V. Allmuça, P. Zogaj, S. Demolli, F. Kulli

# Poezi nga letrarë të rinj

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

*Në këtë antologji janë përmbledhur poezi të disa autorëve, të cilët kanë filluar të debutojnë me krijimet e tyre të para nëpër organet e shtypit.*

**Përgatitur për botim nga**
MUZAFER XHAXHIU,
ADRIATIK KALLULLI,
ISUF NELAJ.

ALBERT RAKIPI

*MBRËMJA E PARË NË FSHATIN E RINISË*

Toka gëzohet siç gëzohet nëna
kur bij e bija i ka pranë.
Ndaj kemi ardhur plot djem e vajza,
që tokën djerr ta kthejmë në arë.

Në fshatin e ri kjo është mbrëmja e parë.
Nuk di se ç'ndiej në gjoks këtë mbrëmje,
ulur tek jam te kjo tokë e tharë.
Toka me zë nëne më thotë «mirseardhe!»

Dielli është fshehur pas pishave të larta,
s'më iket te shokët, i vetëm rri.

---

Autori punon në Shtëpinë e Kulturës Barmash, Ersekë.

Dhe pishat nën yje tundin krahët,
gëzohen dhe ato siç gëzohet një njeri.

Rri e vështroj këtë natë të qetë,
që yje ka ndezur në fshatin e ri.
Sa ç'ka yje sot, nesër drita do të ketë
dhe s'do të ketë fare qetësi.

Ka vetëm dy, tri shtëpi të vjetra sot
dhe nëpër fushë fëshfërin bari i tharë.
Nëpër shtëpi të reja do të ketë plot
dhe grurë e zëra fëmijësh në çdo prag.

## *STACIONE JETE*

Ndalet urbani,
dikush hipën,
dikush zbret,
gjallërohet rruga...

Ndalet këtu,
të hipin punëtorët e gurores
dhe pak më tutje
të zbresë kjo vajzë,
e presin fëmijët në shkollën e fshatit.

Dikush paska harruar në autobus
një tufë luleshqerra,
dhe shoferi qesh:
Paska ardhur pranvera!

Ikin ditët,
ikën një stinë, vjen tjetra
dhe xhamat e autobuzit qëndisen
me lule të bardha.

Kështu
hipin e zbresin njerëzit
me buisjen e stinës që vjen,
me të përditshmet fjalë:
Mirmëngjes!
Mirupafshim!
Punë të mbarë!
Dhe shoferi qesh i lumtur,
kur dikush i vete pranë:
«Të lutem ndale këtu!»
Kështu
shumohen stacionet,
siç shumohet jeta.

Pranë stacioneve të përditshme
pa tabela
shfaqen njerëzit
bashkë me agun e ditës së re.

## *HARTIMI I PARË PËR QEMALIN*

Mbaj mend hartimin e parë për Qemalin.
Ishte pranverë, ishte maj.
Mësuesja temën shkruante në dërrasë,
dega e bajames trokiste në xham.

Hapat dhe zëri i mësueses ndiheshin në klasë
dhe trokitja e bukur e bajames në xham.
«Nxënës! — Qemali më shumë se jetën donte
lirinë,
Qemali u vra të pestën ditë, në maj.»

Dhe të gjithë u kthyem me vrull
dhe Qemalin me patllake në dorë e pamë.
O, ç'fliste vetë ajo pikturë në mur,
për ditën e pestë të muajit maj.

Pastaj në klasë hyri Qemali vetë,
me pushkë në krahë e yll në ballë,
e klasa u mbush plot dritë edhe yje,
e klasa u mbush plot me partizanë...